



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**KOMISIONERI**

Nr. 279/8 Prot.

Tiranë, më 26 . 05 . 2026

**V E N D I M**

**Nr. 120, Datë 26 . 05 . 2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 39, datë 05.02.2026<sup>1</sup>, e z. J.M kundër Shoqërisë së Transportit Shoqëria “El-Alba Trans” sh.p.k<sup>2</sup>, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me datë 18.01.2026 isha në Vlorë dhe në orën 13.40 hipa në autobusin e linjës Vlorë-Tiranë, në vendin e quajtur Pus-Mezin, në orën 15.40 zbrita në Plepa-Durrës, sa kalon urën e Plepave tek karburanti Kastrati. I dhashë shoferit 300 lekë të reja pasi bileta Vlorë-Tiranë është 700 lekë të reja. Kur unë ja dhashë shoferit, ai mi hodhi në tokë dhe më tha çfarë janë këto. Unë i thashë se jam invalid me librezë verbërie dhe sipas ligjit 8098, më takon të paguaj 50% të vlerës. Ai më tha, se unë nuk e njoh ligjin se jam privat. U detyrova të paguaj shumë prej 700 lekëve të reja duke i thënë se unë do të bëj denoncim. Ai më tha se pse nuk më the që kur hipe që unë jam invalid i verbër se unë nuk të merrja ty por merrja një person tjetër që paguan biletën e plotë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tij.

<sup>1</sup> Ankesa është plotësuar me shkresën e DPSHTRR, protokolluar me tonën me nr. 279/4, datë 23.02.2026.

<sup>2</sup> NIPT J62014003V.

<sup>3</sup> Referuar Librezës së Verbërisë nr. serisë 22282, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfutuar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës rezultoi se pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin, i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Vlorë-Tiranë-Vlorë dhe mjetin me të cilin kishte udhëtuar në datë 18.01.2026, ditë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 279/2, datë 09.02.2026, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Me shkresën nr. 2966/1, datë 20.02.2026, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe në platformën elektronike eTransport, rezulton se në itinerarin e transportit ndërqytetës Tiranë-Vlorë-Tiranë, është licencuar për operim shoqëria e transportit “El-Alba Trans” shpk, ndërsa në linjën e transportit ndërqytetas Vlorë-Tiranë-Vlorë, është licensuar për operim shoqëria e transportit “Interbuz Vlora” shpk”. Nga verifikimi i licencave të kompanive, rezultoi se në orarin e pretenduar nga ankuesi, shërbimi ofrohej nga shoqëria El-Alba Trans shpk, e cila kishte orarin e nisjes nga Vlora në orën 13.30.*

Pasi ankesa u plotësua me informacionin e nevojshëm në lidhje me identifikimin e subjektit, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar Komisioneri ndërmori hapat si më poshtë:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 279/3, datë 25.02.2026, ka kërkuar informacion nga Shoqëria “El-Alba Trans” shpk, lidhur me pretendimin e ngritur në ankesë.

Me shkresën nr. 09/03, datë 07.03.2026, Shoqëria “El-Alba Trans”, shpk, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me marrjen e shkresës së Komisionerit, nga ana jonë u punua për identifikimin e targës së mjetit duke u nisur nga të dhënat që jep z. J.M. Në përfundim nuk u bë e mundur të identifikohet targa e mjetit. Asnjë nga drejtuesit e mjeteve që kanë lëvizur paraqatë dhe mbas orës 13.40, nuk pranon të ketë ndodhur një veprim i tillë.*

*Shoqëria El-Alba Trans shpk, e ofron shërbimin e transportit për personat me AK, dhe në veçanti të personave të verbër, bazuar në lehtësitë financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.*

*Ne me këto probleme pothuajse ndeshemi herë pas here. Kërkesa jonë ndaj drejtueseve të mjeteve ka qenë dhe mbetet zbatim pa ekuivok i kërkesave të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.*

*Çdo drejtues mjeti është i pajisur me Certifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse. Certifikata e ka të shkruar qartë në pjesën e mbrapme të saj, se kush udhëton falas dhe drejtuesit e mjeteve e dinë këtë, dhe në përgjithësi zbatohet nga drejtuesit e mjeteve.*

*Problemi që lind, në raste të veçanta, është paraqitja e dokumentit të invalidit dhe qëndrimi që mban drejtuesi i mjetit për dokumentin. Këto janë veprime subjektive, pse jo dhe për interesa vetjake, nisur nga fakti që shërbimi është privat, por me këtë qëndrim shkelet ligji. Si Shoqëri,*

nuk kemi patur ankesa nga persona që kanë statusin e të verbërit, para apo tetraplegjikë, etj”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm**

Në ankesën e depozituar nga ana e z. J.M, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, i verbër, nga ana e Shoqërisë së Transportit “El-Alba Trans” sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës për të udhëtuar në transportin ndërqytetas, me biletë me gjysmë çmimi.

Ankuesi informon se, në datën 18.01.2026 ka hipur në Vlorë, pa specifikuar ndonjë element për të identifikuar autobuzin me të cilin ka udhëtuar, për të shkuar në Tiranë, në orën 13.40. Në ankesë, z. M nuk informoi për llojin e librezës që i ka treguar shoferit, por informon se kur ka zbritur nga autobusi në Plepa, Durrës, shoferi nuk ka pranuar pagesën me gjysmë bilete sipas parashikimeve të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, por i ka kërkuar që të paguajë biletën e plotë.

Lidhur me këtë, Komisioneri me shkresën nr. 279/3, datë 09.02.2026, ka kërkuar nga ankuesi informacionin si më poshtë: “Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ju deklaroni se, gjatë udhëtimit tuaj në datë 18.01.2026, i keni “thënë shoferit se jam invalid me librezë verbërie”. Sa më sipër, kërkohet nga ana juaj të informoni Komisionerin se: A i keni paraqitur shoferit librezën apo i keni deklaruar se jeni i verbër dhe nëse keni paraqitur librezë, cilën keni paraqitur, librezën e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës Shpresë për të Verbërit?”. Ankuesi nuk ka kthyer përgjigje.

Shoqëria e Transportit “El-Alba Trans” sh.p.k, ka informuar se asnjë nga mjetet e transportit që kanë udhëtuar në atë orar (ora 13.00; 13.30) nuk kanë pranuar se ka ndodhur një ngjarje e tillë dhe se Shoqëria e ofron shërbimin e transportit për personat me AK, bazuar në lehtësitë financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat për identifikimin e subjektit që pretendohet të ketë kryer veprimin diskriminues, duke komunikuar me DPSHTRR dhe me subjektin që është i licencuar për transportin e udhëtarëve në linjën Vlorë-Tiranë. Në përgjigjen e dhënë nga subjekti “El-Alba Trans” sh.p.k, rezulton se nuk ka identifikuar autobusin në të cilin ka ndodhur ngjarja e pretenduar, gjithashtu dhe ankuesi nuk ka dhënë informacion më të plotë lidhur me ngjarjen, në mënyrë që Komisioneri të mund të vlerësonte provueshmërinë e pretendimeve të tij.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat që janë vënë në dispozicion nga palët, si dhe atyre të grumbulluara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri për

Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk arriti të konstatojë se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë nga ana e Shoqërisë “El-Alba Trans” sh.p.k.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shoqëria “El-Alba Trans” sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar në dëm të ankuesit, z. J.M.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, z. J.M nga ana e Shoqëria “El-Alba Trans” sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta TAFA (BUNGO)**